

INTERVISTË EKSKLUZIVE PËR KOMBËTAREN "BOTA SOT" E SHKRIMTARIT TË MIRËNJOHUR GJËKË MARINAJ (2)

AJO QË KISHA NDIËR PËR KOSOVËN KA NË VETVETE DIÇKA TË SHENJTË


"Bota sot": Njëri nga problemet themelore që ka letërsia shqipe është se akoma i munjon njohja brenda vetvetes. Procesi i letërsisë sonë kryesisht zhvillohet brenda bërthamës së hapësirave të kufijve shtetëror, andaj nevoja e integritimit të letërsisë brenda dashqiptare është e domosdoshme. Pra, z.Marinaj, çka do të thotë komunikimi gjithëshqiptar për një krijues dhe sa ka rëndësi kjo në ngritjen e cilësisë së letërsisë sonë, e cila, për shkaqe tashmë të njohura, gati për gjysmë shekulli në esencë mbeti e ndarë?

Gjekë Marinaj: Shqetësimi juaj është indikativ i një problemi serioz. Por ai është edhe më serioz në raportin e letërsisë shqipe me atë të huaj. Nocioni i vlerave letrare që japin autorët tanë nganjëherë nuk përputhet me vetëdijen e lexuesit për t'i shijuar në maksimum ato. Sot jetojmë në një kohë kur inteligjenca individuale e dashamirësve të letërsisë shqipe ka pësuar një etje të ngjashme me ato të koncepteve dehëse për "civilizim" të shpejtë, që patën pësuar dikur evropianët në kërkim të letërsisë së mesjetës. E mira është se shtegtimi drejtë ekstremes, drejt artificiales, drejt të kundërtës së thellësisë së vetvetes nuk është një fenomen as i ri as shqiptar. Shenja të tilla padurimi kanë shfaqur grekët gjatë e periudhës arkaike, duke lënë më një anë Heziodin e Homerin, për t'u kthyer tek Semonides, Tyrtaeus, e më vonë te Sapo e Alkaios. Lexuesi persian në kohën e Rumiut të madh është drejtuar tek autorë të huaj, më të vegjël se ai, në kohën e tij. Madje edhe gjatë renesancës as Shekspiri as Servantesi nuk e gëzuan peshën e tyre të vërtet autoriale midis bashkëkohësve të tyre. Në realitetin tonë vetëm gjenialiteti i Kadarese gjendet i shtruar në ekzistencën e mirënjohjes së plotë kolektive. Por ne kemi plot shkrimtarë e poetë shqiptarë brilant, që librat e tyre mënjanojnë nëpër librari, kur përkrah tyre gjendet një shkrimtar i huaj i përkthyer në shqip, pavarësisht se ai është krejtësisht i panjohur, pavarësisht se komponentët e përgjithshëm që përbëjnë letërsinë e tij mund të jenë fare mirë inferior përball atyre të autorëve shqiptarë. Konkluzioni që mund të nxirret nga ky shqetësim duhet patjetër të alarmojë sistemin arsimor dhe qarqet akademike shqiptare. Fëmijët dhe të rinjtë tanë duhet të qartësohen se vlerat më të mëdha etike e tematikat më të përshatshme për kulturën tonë gjenden në letërsinë e autorëve tanë. Për sa u përket vlerave estetike, ata duhet të qar-

tësohen se ato nuk kanë gjeografi: nganjëherë i gjen më të mëdha në letërsinë tonë e nganjëherë në atë të huaj. Pikërisht për interesin që ka njeriu për të bukurën, aventurën, kuriozitetin, lexuesi ynë nuk duhet të heq dorë kurrë as nga letërsia shqipe aq nga letërsia e huaj. Por letërsia shqipe, mbarëshqiptare duhet patjetër të dominojë bibliotekat personale dhe orët argëtuese të shqiptarëve.

"Bota sot": Nën ç'emër kohor mendon se do të arkivohet apo katalogohet letërsia e sotme shqipe dhe botërore, thuaj pas 50 apo 100 vjetësh?

Gjekë Marinaj: Letërsia e sotme botërore, që tashmë është në prag të shpërndarjes së plotë me modernizmin dhe në largim gradual nga post-modernizmi, ka kohë që ka filluar të nxjerrë "fiskla" dhe të shprehë "pakënaqësinë" e saj ndaj identifikimit si letërsi e njëjtë me letërsinë e dy-tri dekadave të mëparshme. Por kjo pritej. Profesorët e letërsisë së kolegjeve dhe universiteteve më të famshme të botës kanë ofruar me shkrim tek bordi i MLA propozimet e tyre se cili do të ishte emërimi më i përshatshëm dhe drejtimi më efikas për periudhën më të re letrare, duke filluar nga e sotmja. Para një muaji mora vesh se ishin zgjedhur katër propozimet finale nga ku do të dalin ai fitues, që do të shpallet në konferencën e Marsit, 2009 në Boston. Katër finalistët janë Universalizmi, Protonizmi, Neologjizmi, dhe Neobudizmi. Në dy fjalë (përkufizimet e mia këto) Universalizmi, sugjeron që koordinatat e realitetit dhe të fantazisë të kenë një lirshmëri veprimi prej 180 gradësh, pa u futur as në skajet e formave të së kaluarës as në ato të së ardhmes. Protonizmi, ka dalë me idenë se gjithëcka letrare duhet të trajtohet si një esencë me ngarkesë pozitive, duke i lënë në heshtje ato letërsi që nuk meritojnë vlerësim pozitiv. Neologjizmi, i cila unë personalisht shpresoj të fitojnë, lufton për një letërsi që, pa lënë pas dorë të tanishmen, ecën një hap para kohës si në formë ashtu edhe në përbërje, duke sjellë një letërsi të filtruar nga formati tradicional. Dhe Neobudizmi (propozuar nga universitetet e Azisë) si rryma më e re letrare në fuqi, do të siguronte injektimin e një mendimi kritik, por të rinovuar në letërsi, ku mendimet në fundin e tyre t'u japin një farë zgjidhje problemeve që shtrojnë dhe jo të figurojnë si të akullta. Të shohim se cila ide do fitojnë, por njëra prej tyre mendoj se është e pashmangshme.



Kujdesi për estetikën është gjithmonë në qendër të vëmendjes sime

"Bota sot": Lëvroni poezinë modernë në kuptimin e mirëfillt të fjalës. Qasja e objektit artistik, si dhe mënyra e të shprehurit, janë sa të veçanta aq edhe të pasura. Poezinë e ndërtoni duke ndërlidhur shtresa të ndryshme të dukurive ose të botës së motivit, apo tematikës, kryesisht përballë vetvetes, përballë tjetrit ose mjedisit përkatës. Ç'do të thotë kjo për një krijues dhe për veprën e tij?

Gjekë Marinaj: Do të thotë përgjegjësi autoriale në kuptimin më real të fjalës. Poezia nga natyra është një gjini letrare sfiduese, sidomos për lexuesit që nuk e konsiderojnë këtë formë arti si një nga njohuritë e theksuara të logjikes së tyre formale. Me këtë në mendje mundohem të krijoj për të gjithë ata që kanë nevojë për poezi. Dhe nevojë për poezi kanë të gjithë ata që kanë nevojë për oksigjen, pavarësisht se shpesh njerëzit e marrin poezinë nga forma jo direkt letrare, si nga dashuria, natyra, bukuria, e vërteta etj. Ndaj kujdesi për estetikën është gjithmonë në qendër të vëmendjes sime. Estetika në formën e saj më të mirë ka një fuqi të vërtet stimuluese, ajo sikur

mendoj shumë dhe të menduarit sikur ma shton dëshirën për ta sakrifikuar rehatinë trupore në të mirë të letërsisë. Të menduarit shpesh më kalon në një meditim natyral, gjë që me të dalë prej tij, ndjej të mërritet intensiteti, të më aktivizohen emocionet dhe të më zgjerohen perceptimet për jetën, pavarësisht nga lodhja mendore apo fizike që mund të ndjej.

"Bota sot": Çfarë mund të na thoni më gjerësisht rreth librit tuaj të fundit me poezi të titulluar "Lutje në ditën e tetë të javës", të botuar nga Shtëpia Botuese "Faik Konica" që sapo u promovua këtu në Prishtinë?

Gjekë Marinaj: Poezia nuk mund të gjykohej kurrë objektivisht nga autori i saj. Poezia ime flet më parë me mua, pastaj me ata për të cilët e krijoj atë. Unë shkruaj me mendimin se ndjenjat e së tanishmes së bashku me ato konceptuale sugjerojnë që shfaqja e dramacitetit njerëzor është në të njëjtën kohë e shoqëruar me përmirësim në disa aspekte të funksioneve monumentale të gjendjes psikologjike të njeriut. Për këtë e kam ndjerë si të domosdoshme që t'i lejoj dhe t'u besoj zërave jetësor që më vijnë nga pavetëdija dhe vetëdija në varg. Ata zëra kanë komunikuar me mua nëpërmes ëndrrave, nëpërmes instinktit. Ata më kanë shtyrë të përdor të gjitha fuqitë e mendimit dhe të arsyes, të gjitha njohuritë, të gjithë fuqinë dhe delikatesën e ndjenjave, të gjithë mençurinë praktike dhe finesën e intuitës që kam, për të krijuar këtë libër. Unë e vlerësoj poezinë si gjënë më të çmuar që mund të më dhurojë dikush dhe mund të dhuroj dikujt, sepse ajo më lejon të flas me një fuqi që nuk është e parashikuar në kodet e kulturës së kohës. Poezi më ofron mundësinë që të marr pjesë në përvojat specifike të njerëzve, duke më lejuar të gëzoj dhe vuaj me ta paralelet e këtij procesi. Pikërisht për këtë gjithmonë ruhem që në poezinë time të mos ketë më shumë poetizim se sa është nevoja. Nëse poezia shpëputet, më larg se sa duhet, drejt mbretërisë së ritmit, formës, filozofisë e makijazhit sipërfaqësor dhe nuk e vënë re anën tjetër të ekzistencës—historinë në të cilën jetojmë, me ndriçimet edhe errësirat e saj—atëherë jeta rrjedh jashtë poezisë dhe kthehet në një ikje, në një bjerrje. Lutje në ditën e tetë të javës është maksimumi im poetik, ndaj më gëzon pa masë fakti që kritika letrare e ka njohur dhe pranuar atë si të tillë.

**- Faleminderit!
- Qofshi me nder!**

Intervistoi: Mikel Gojani